

VENDIM
Nr.254, datë 27.4.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 15 238 M²
DHE TË OBJEKTEVE QË NDODHEN BRENDË SAJ NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E BRENDSHME DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË
18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 15 238 m² dhe objektet, që ndodhen brenda saj, komponentë të pronës me numër rendor 237, “Ish-brigadë tankesh” Kareç, Durrës, me numër pasurie 8, në zonën kadastrale nr.2/01, pronë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për ngritjen e qendrës së mbyllur të pritjes, për migrantët e parregullt.

2. Listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, t’i hiqet sipërfaqja 15 238 m² dhe objektet, që ndodhen brenda saj, komponentë të pronës me numër rendor 237 “Ish-brigadë tankesh”, Kareç, Durrës.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet t’i ndryshojë pronës destinacionin e përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANVENDOSJA E REPARTIT USHTARAK NR.1400. ISH BATALIONI I TANKEVE KARREÇ MAMINAS

